




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dej. Dep.	2-D/DPK
Nr. llog. Broj. strauca Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	01-1254/13
Data Datum Date	24-04-2013
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë 23.04.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. ***Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-911/13 për ztr. Ismet Lecaj – Drejtor i Telemjekësisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.***

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-911-13, për Zyrtarin e lartë, z. Ismet Lecaj – Drejtor i Telemjekësisë në QKUK – Ministria e Shëndetësisë, dhe njëkohësisht pronar dhe person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-911/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Lecaj së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konflikti të interesit.

Zyrtari i lartë, ztr. Lecaj është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, për të vazhduar të ushtroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, z. Lecaj, në Agjenci ka sjellur një shkresë zyrtare (DPK / DPKI – 03 -1177/13) të përcjellë edhe me dokumentin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë në të cilën shihet se z. Lecaj i ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznes, duke hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar në ndërmarrjen private “ITel” Sh.p.k. dhe duke e emruar në këtë pozitë një person të tij të besuar.

Prandaj në bazë të provave zyrtare të ofruara e të trajtuara lidhur me këtë rast, kemi konstatuar se nuk ka pasur konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

